

Relacion Edukimi në Vazhdim Janar – Dhjetor 2018

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, krahas detyrave të tjera ka për mision edhe ngritjen profesionale të farmacistëve. Nga UFSH kjo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe planifikimit të programeve të kualifikimit të vazhdueshëm. Nga analiza që QKEV ka bërë, UFSH rezulton se është ofruesi kryesor për aktivitetet e edukimit në vazhdim për farmacistët në vend. Për të përmbushur sa më mirë detyrimin tonë me profesionistët farmacistë kemi ofruar aktivitete nëpër të gjitha rajonet e Shqipërisë, bazuar edhe në numrin e farmacistëve dhe nevojat për kredite për secilin rajon.

Gjithashtu, jemi mbështetur në marreveshjen e bashkëpunimit që kemi me qendrën e “Telemedicinës” pranë QSUT, e cila na ka vendosur në dispozicion pa pagesë sallat e saj në Tiranë dhe në të gjitha rajonet e Shqipërisë, për zhvillimin e **Videokonferencave**. Videokonferencat janë një metodë mjaft efikase për të ulur në maksimum kostot për secilin aktivitet dhe për të shtuar numrin e krediteve të ofruara për secilin rajon. Duke shfrytëzuar këtë mundësi të ofruar nga Qendra e Telemjekësisë së Shqipërisë, seminarët i kemi ofruar në të gjitha rajonet e Shqipërisë duke përfshirë dhe dy zona të skajshme sic është Saranda dhe Tropoja.

Gjatë 6 mujorit të parë UFSH ka ofruar 32 kredite. Prej të cilave 22 kredite janë ofruar nga Konferenca e V farmaceutike “**Se bashku për Farmaceutiken**” dhe 10 kredite janë ofruar drejtëpërdrejtë nga UFSH me anë të videoleksioneve për secilin rajon të Shqipërisë, aktivitete të cilat për rajonin e Tiranës, si rajoni me numrin më të madh të pjesëmarrësve, cdo aktivitet është përsëritur 2 herë. Ajo e cila vlen të theksohet se sikurse vitin e kaluar është fakti që këto seminare janë ofruar **pa pagesë** për farmacistët.

Në datat 29-30-31 Mars u zhvillua Konferenca e V farmaceutike “**Se bashku për Farmaceutiken**” në 2 salla paralele në ambientet e Hotel Tirana International. *Aktiviteti u zhvillua sipas programit dhe pjesëmarrësit shfaqën shumë interes duke bërë këtë aktivitet shumë interaktiv. Kjo konferencë paraqiti 69 prezantime orale dhe poster me pjesëmarrjen e lektorëve më në zë vendas dhe të huaj.*

*Vlen të përmendet pjesëmarrja e **Zv/Presidentes së FIP znj. Eeva Teräsalmi** si e ftuar nderi. Bazuar në pyetësorët e vlerësimit të aktivitetit organizimi dhe temat e prezantuara u vlerësuan maksimalisht.*

Vlen për tu theksuar se nga monitorimi i QKEV-së, rezultoi se Konferenca V-të Farmaceutike “**Së bashku për Farmaceutikën**”, e organizuar nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në bashkëpunim

me Odën e Farmacistëve të Kosovës dhe Departamentin e Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT Tiranë u dallua për përmbushje maksimale të standardeve të edukimit në vazhdim. Plotësimi i standardeve konsistoi në nivelin e lartë shkencor të prezantimit nga ana e lektorëve, në respektimin me rigozitet të programit të aktivitetit, si dhe standardeve të tjera të cilësisë, për të cilat kjo Konferencë përfitoi rritje të numrit të krediteve (nga 18 kredite e parashikuar, në 22 kredite).

Në datën 8 qershor dhe 22 qershor 2018 është zhvilluar aktiviteti me temë **“Rezistenca bakteriale dhe trajtimi i Leucemis Mieloide Kronike”** me lektore Prof. Dr. Polikron Pulluqi dhe Prof.Dr.Myftar Barbullushi , ku farmacistet përfituan 4 kredite.

Në datën 29 Qershor dhe 6 Korrik është zhvilluar aktiviteti me temë **“FARMAKOVIGJILENCA DHE SIGURIA E BARNAVE”** me lektorë Prof. Asoc. Mirela Miraci, Dajana Roshi dhe Jovisa Marku, ku farmacistët përfituan 6 kredite.

Këto aktivitete u zhvilluan në Tiranë pranë Telemedicinës me transmetim në Shkodër, Kukës, Dibër, Tropojë, Lezhë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Berat, dhe Sarandë.

Në datat 25-26 Tetor 2018 në ambjentet e Pallatit të Kongreseve u zhvillua konferenca me titull: **“Se bashku për mjekësin, së bashku për pacientin”** , ku u ofruan 6 kredite për farmacistët. **Vlen të përmendet bashkepunimi midis Urdhrit të Farmacistit dhe Urdhrit të Mjekut.**

Aktivitetit i fundit për 2018 ishte **“NË SHËRBIM TË NGRITJES PROFESIONALE TË FARMACISTËVE, EDUKIMI VAZHDON...”** i cili u zhvillua 5 ditë nga data 11-17 dhjetor 2018 me 26 kredite. Ky aktivitet u përsërit në datat 18-19-20-21-24 dhjetor 2018.

Urdhri i Farmacistëve vetëm për 2018 ka ofruar 64 kredite në total.

Problematikat e hasura nëpër aktivitetet e edukimit në vazhdim vihet re se janë të përsëritura ndër vite, dhe janë:

- Pjesëmarrje fiktive
- Aktiviteti nuk zgjat sipas programit

Sikurse është vepruar edhe këtë vit për disa aktivitete, janë bërë lista të diferencuara në varësi të orëve të qëndrimit, një mënyrë e përdorur për të mbajtur pjesëmarrësit prezent. Gjithashtu është parashikuar që për 2019, në mënyrë që të rritet efektiviteti i ketyrë aktiviteteve të zhvillojmë më shpesh dhe më të shkurtër, si dhe tematikat të jenë më të prekshme për farmacistët dhe pjesëmarrësit në to.